



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 761/4 Prot.

Tiranë, më 05/10 /2015

VENDIM
“ Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 46, datë 05/10 /2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Z. , përfaqësuar me prokurë të posaçme nr.rep 2653, nr.kol 1063 datë 02.06.2015 nga Av. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 761/1 Prot., datë 15.09.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit me kërkesën e datës 22.07.2015 me objekt “ Dhënie informacioni”, ka kërkuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë, të informohet lidhur me regjistrimin e Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi me nr. 1 3 7 (AMTP), në emër të z. Zef Preng Hasani, dhe t’i vihet në dispozicion ekstrakti i regjistrimit të tij, nëse ekziston, sipas vërtetimit të datës 29.06.1998 të Zyrës së Hipotekës Pukë (sot Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme). Në rast të mungesës së dokumentacionit, kërkohet informacion për dokumentet që duhen lidhur me regjistrimin e titullit të pronësisë . Aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 1 3 7, datë 30.07.1997.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se, Autoriteti Publik/ Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë nëpërmjet shkresës nr.2250/ 1 Prot., datë 31.07.2015 i ka kthyer përgjigje kërkuesit duke sqaruar se “ për tërheqjen e informacionit të

kërkuar duhet të paraqitet pranë ZVRPP Pukë për të aplikuar kundrejt tarifave përkatëse”.

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim në zyrën e Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, verifikimit të fakteve dhe hazës ligjore të saj, në zbatim të nenit 24, pika 3 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, me anë të shkresës nr. 761/2 Prot., datë 18.09.2015,

kërkoi nga ana e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë të paraqesë parashtrime me shkrim lidhur me kërkesën e Z. dhe të vlerësojë dhënie e informacionit të kërkuar brenda datës 25.09.2015.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë, me anë të shkresës nr. 2587/1 Prot., datë 21.09.2015, ka kthyer përgjigje duke informuar kërkuesin se, Akti i marrjes së

tokës në pronësi me nr.137, nuk rezulton i regjistruar në formularin nr.6 të Regjistrimit Kadastral si dhe nuk mund të pranohet për regjistrim pasi ky akt nuk është në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.2, datë 13.06.2013. Gjithashtu, ZVRPP sqaron se ky akt nuk mund të pranohet pasi është në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil si dhe nenin 25 të Ligjit nr.33/2012. Në vijim ZVRPP, rezulton ti ketë kërkuar kërkuesit të paraqitet në sportel, për të aplikuar në zbatim të nenit 68 dhe 71 të Ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik/ Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka përmbushur detyrimin në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" duke i kthyer përgjigje kërkuesit brenda afateve ligjore.

Në përfundim, në lidhje me ankesën e Z. ndaj Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë, Komisioneri vlerëson se ajo rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën e) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 761 /1Prot., datë 15.09.2015 të Z. , kundër Autoritetit Publik/ Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Ky vendim u dha sot në datë 05.10.2015.

